# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-450029**
VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Dënimi me 81 vite burg i ish-liderëve të UÇK-së, Vuçiç: Nuk u dënuan për krime kundër njerëzimit - Euro news Albania |
| ADRESA | `https://euronews.al/denimi-me-81-vite-burg-i-ish-lidereve-te-uck-se-vucic-nuk-u-denuan-per-krime-kunder-njerezimit/` |
| BURIMI | euronews.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 16 shtator 2026, 17:18:11 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 16 shtator 2026, 17:12:32 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `b300aeec8f68b8478b51fa5430626aab13deefe33a641b45dc71ba66ec52ef5f` |
| TEKSTI | `f9ddcee19f69f8cced204ba58df35862045942ea0b5cd7973c11a04463a7887c` |
| PAMJA | `e237d49d82388118e68e0bb95bab83a8b167b28c32cc92fa366373d8e6872e9b` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `397c24c3f747e895c2d8de77c770527a1eec893387f082e3f954cf6ea8b6e7a4` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `9515102868483048fab913125dfd13516db18986db3bd96a2369642ebf1c0d96` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/397c24c3f747e895c2d8de77c770527a1eec893387f082e3f954cf6ea8b6e7a4`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

EURONEWS ALBANIA | KOSOVË

# Dënimi me 81 vite burg i ish-liderëve të UÇK-së, Vuçiç: Nuk u dënuan për krime kundër njerëzimit

16 Shtator 2026 | 19:12

SHPËRNDAJE ARTIKULLIN

Presidenti serb Aleksandar Vuçiç reagoi pas vendimit të shkallës së parë të Gjykatës Speciale në Hagë ndaj Hashim Thaçit, Jakup Krasniqit, Kadri Veselit dhe Rexhep Selimit, duke deklaruar se Serbia duhet të ruajë paqen dhe stabilitetin dhe të përballet me të kaluarën përmes dialogut.

Në një konferencë për mediat, Vuçiç kritikoi Dhomat e Specializuara të Kosovës, duke pretenduar se vendimi nuk përfshin disa nga akuzat dhe krimet e pretenduara ndaj serbëve. Ai vuri në dukje se katër ish-drejtuesit e UÇK-së u dënuan gjithsej me 81 vjet burgim.

Vuçiç tha gjithashtu se në vendim nuk janë përfshirë krime kundër njerëzimit.

“E gjithë kjo nuk u mor parasysh dhe, siç thashë, këto gjashtë akuza, të cilat kanë të bëjnë me krimet më të rënda kundër njerëzimit, nuk u shpallën fajtorë. Nuk kemi arsye të jemi të lumtur ose të trishtuar”, tha Vuçiç.

Ai shtoi se emocionet e larta që lindin dekada pas konfliktit në territorin e ish-Jugosllavisë tregojnë se, siç tha ai, “u bë shumë padrejtësi”, por edhe se shoqëritë nuk ishin mjaftueshëm të përgatitura për t’u përballur me gabimet dhe krimet e tyre të kryera në emrin e tyre.

“Për Serbinë, ruajtja e paqes dhe stabilitetit është me rëndësi thelbësore; për vendin tonë, nuk ka asgjë më të rëndësishme se kaq. Por mendoj se sigurisht në të ardhmen zgjidhja qëndron në bisedë, mirëkuptim dhe dialog më të madh me të gjithë”, tha Presidenti i Serbisë.

**Shiko në:**

LAJMI I FUNDIT

19:08 Berisha nis “Foltoren e Ripërtëritjes” nga Kruja: Duhet t’i japim zgjidhje kësaj rrokullisjeje

18:44 Guterres: Këshilli i Sigurimit është i paralizuar nga përçarjet mes fuqive të mëdha

18:35 Bajraktari: Vendimi i Speciales skandaloz, skena politike në Kosovë të bëhet bashkë

18:31 Të dhënat e qindra klientëve të evropianë të një banke dixhitale bien në duart e hakerëve

18:31 “Do t’i biem pishmanit, por do jetë vonë”, momenti kur Rexhep Selimi i lutej Jakup Krasniqit kundër Gjykatës Speciale (VIDEO)

18:15 Zhduket 3-vjeçari nga këndi i lojërave në Angli, mbi 1 000 persona mobilizohen në kërkime për gjetjen e tij



## | LAJME TE SUGJERUARA

EURONEWS ALBANIA | KOSOVË | RAJONI

### Rexhep Selimi dënohet nga Haga me 13 vite burgim

Rexhep Selimi është dënuar me 13 vjet burgim nga Dhomat e Specializuara në Hagë. Trupi gjykues e shpalli Selimin fajtor për krime lufte, përfshirë trajtimin...

11:45 | 16/09/2026

EURONEWS ALBANIA | KOSOVË | RAJONI

### Kadri Veseli dënohet me 18 vite burgim

Kadri Veseli është dënuar më 18 vjet burgim. Gjykatësi Charles Smith ka thënë se pas shqyrtimit të të gjitha provave Veseli është shpallur fajtor për...

11:42 | 16/09/2026

EURONEWS ALBANIA | KOSOVË | RAJONI

### Haga jep dënimin për Jakup Krasniqin, dënohet me 25 vite burgim

Jakup Krasniqi është dënuar me dënim prej 25 vjet burgim nga Gjykata Speciale në Hagë. Trupi gjykues e ka shpallur të fajshëm për trajtim dhe...

11:39 | 16/09/2026



Copyright © Euronews 2026

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.